





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr.12/2021

Bordi për Ankesa (BA), i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyll Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2012/297/BA/yf të datës 08.03.2021 të parashtruesit “Radio Televizioni i Kosovës-RTK 1”, të paraqitur ndaj Vendimit Ref:2102/79/KPM/xhl, të datës 28.01.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar Ankesa e RTK 1 Ref:2012/297/BA/yf e datës 08.03.2021, kundër Vendimit të Komisionit Ref:2102/79/KPM/xhl të datës 28.01.2021, sa i përket shkeljes se nenit 5 paragrafi 5 dhe nenit 7 paragrafit 6 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, ndërsa pjesa tjetër e Vendimit mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref:2102/79/KPM/xhl e datës 28.01.2021, e ka sanksionuar me Vërejtje RTK 1 si Palë përgjegjëse në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit të Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave për shkelje të nenit 5, paragrafi 2 dhe 5, nenin 6, paragrafi 1, si dhe në nenit 7 paragrafi 6 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “Radio Televizioni i Kosovës RTK 1” me datën 08.03.2021 ka parashtruar Ankesë pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: vërtetimit plotësisht të gabuar të gjendjes faktike, injorimit të kërkesave të Bordit për arsyetimin e Vendimit dhe gabimeve procedurale e materiale të nxjerrjes gjatë Vendimit dhe provave të reja relevante për rastin, me propozim që Bordi për Ankesa të aprovojë Ankesën e Palës përgjegjëse dhe të ndryshojë Vendimin e Komisionit të Pavarur për Media Ref:2102/79/KPM/xh.l të datës 03 shkurt 2021 dhe Ankesa e palës të vlerësohet e pabazuar.

Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datë 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Radio Televizionit të Kosovës-RTK 1”, si Palë përgjegjëse me Vendimin kontestues Ref:2102/79/KPM/xh.l të datës 03 shkurt 2021.

Bordi për Ankesa ka konstatuar se qëndrimet ankimore të Palës ankuese kundër Vendimit Ref:2102/79/KPM/xh.1 të datës 03 shkurt 2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të qëndrueshme dhe të bazuara pjesërisht sa i përket shkeljeve të nenit 5 paragrafi 5 dhe nenit 7 paragrafit 6 të Kodit të Etikës KKPM–2016/03 për Palën përgjegjëse pasi që KPM në Vendimin e saj nuk e ka argumentuar me as një fakt - provë se Pala përgjegjëse gjatë emisionit kontestues ka bërë shkelje të Kodit të Etikës, respektivisht të nenit 5 paragrafi 5, që përcakton:

“OSHM-të nuk duhet të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtje dhe pabarazinë dhe që mund të rezultojnë me veprim kriminal ose të dhunshëm kundër një individ apo grupi.”

Gjithashtu Bordi, konstatoi se KPM me Vendimin Ref:2102/79/KPM/xh1 të datës 03 shkurt 2021 nuk ka arritur të argumentojë me asnjë provë se Pala përgjegjëse gjatë emisionit kontestues ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 6 të Kodit të Etikës KKPM–2016/03, me të cilin përcakton:

“Programet që kanë qëllim të keq, përmbajnë kritikizëm të padrejtë apo sulm në një person fizik apo juridik, janë të ndaluara.”

Ndërsa, sa i përket shkeljeve tjera, respektivisht nenit 5 paragrafi 2 dhe nenit 6 paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM–2016/03, të cekura me Vendimin Ref:2102/79/KPM/xh1 të datës 03 shkurt 2021, Bordi pas shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve ankimore kundër Vendimit kontestues, konstaton se KPM në Vendim ka argumentuar mjaftueshëm me prova për shkeljet e neneve përkatëse.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi me shumicë votash si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:
-Palëve dhe
-Arkivit të KPM-së.



Ylber Fetahaj
Kryetar i Bordit për Ankesa